# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-443588**

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa, PD: Klimë gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë |
| ADRESA | `https://piranjat.al/politike/kercenimi-me--i-gazetarit-osman-stafa-pd-klime-gjithnje-e-me-armi-i104057` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 15:15:55 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 15:13:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `110a9796d799871ff5e4c34ed80991c1717363c69613786039074801ae739860` |
| TEKSTI | `c785a935f6978240adac9073f868916ad663a0e92aea3d09f94407c5ceb28efa` |
| PAMJA | `3abde9a8c179e87a4297e846c544a802fa7ce8712ecd7caff2d442a40b5bfbce` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `dfe70eca787d06051cccc67fa786314854818234c9b3d08bd8c2483722bcbf46` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `e0b9829abbee6aeaf0cbfff89c7cd5e0dcc89e0fb08f67fff94e9a06c82fe2c5` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/dfe70eca787d06051cccc67fa786314854818234c9b3d08bd8c2483722bcbf46`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

POLITIKE

# Kërcënimi me vdekje i gazetarit Osman Stafa, PD: Klimë gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 17:13



Partia Demokratike ka reaguar në lidhje me kërcënimin me jetë ndaj gazetarit Osman Stafa pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit. Në reagim theksohet se rasti nuk mund të trajtohet si një episod i vetëm dhe se kjo ngjarje është pjesë e një klime gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë, të krijuar nga një qeveri që i përgjigjet denoncimit me presion, intimidim dhe frikësim

PD kërkon identifikimi dhe vënien përpara drejtësisë të autorit të kërcënimit; zbardhjen e lidhjes së mundshme ndërmjet kërcënimit dhe pamjeve të publikuara; identifikimin zyrtar të katër punonjësve të policisë dhe sqarimin e urdhrave mbi bazën e të cilëve kanë vepruar pa uniformë; dhe vlerësimin e rrezikut dhe garantimin e mbrojtjes së gazetarit Osman Stafa.

Deklarata:

Partia Demokratike dënon me forcë kërcënimin me vdekje ndaj gazetarit të Neës24, Osman Stafa, pas publikimit prej tij të pamjeve nga protesta përpara Kuvendit. Katër personat me veshje civile të dokumentuar në pamje gjatë ndalimit të një protestuesi janë punonjës policie. Fakti që efektivë të Policisë së Shtetit ndërhyjnë pa uniformë dhe pa shenja identifikuese ndaj protestuesve paqësorë ngre shqetësime serioze për veprime të paligjshme dhe përpjekje për t'iu shmangur përgjegjësisë.

Kërcënimi ndaj gazetarit pas publikimit të këtyre pamjeve nuk mund të trajtohet si një episod i zakonshëm. Ai duhet hetuar urgjentisht, duke përcaktuar jo vetëm autorin e mesazhit, por edhe nëse kërcënimi lidhet me ekspozimin e punonjësve të policisë dhe me veprimtarinë profesionale të gazetarit. Kjo ngjarje është pjesë e një klime gjithnjë e më armiqësore ndaj fjalës së lirë, të krijuar nga një qeveri që i përgjigjet denoncimit me presion, intimidim dhe frikësim. Kur gazetarët kërcënohen sepse dokumentojnë sjelljen e policisë, synimi është i qartë: të heshtet media, të fshihen abuzimet dhe qytetarët të privohen nga e drejta për të ditur të vërtetën.

Partia Demokratike kërkon:

-identifikimin dhe vënien përpara drejtësisë të autorit të kërcënimit;
-zbardhjen e lidhjes së mundshme ndërmjet kërcënimit dhe pamjeve të publikuara;
-identifikimin zyrtar të katër punonjësve të policisë dhe sqarimin e urdhrave mbi bazën e të cilëve kanë vepruar pa uniformë;
-vlerësimin e rrezikut dhe garantimin e mbrojtjes së gazetarit Osman Stafa.

Heshtja ose zvarritja nga institucionet do të përbënte mbrojtje politike për kërcënuesit dhe një mesazh frikësues për çdo gazetar që guxon të dokumentojë abuzimet e pushtetit.

Partia Demokratike qëndron në solidaritet të plotë me Osman Stafën dhe me çdo gazetar që mbron interesin publik.
Narkopolicia nuk do ta fitoje betejen me fjalën e lirë!

## Artikuj te sugjeruar

POLITIKE 14 Shtator16:24

### ['Kreu i 5D, Erjon Veliaj pret lirinë', Kël̈liçi: A do ta mbrojë Gjykata e Lartë zyrtarisht korrupsionin?]

Nga Belind Këlliçi Nesër kreu i 5D pret lirinë, por a do të mbrojë Gjykata e Lartë zyrtarisht korrupsionin?! Me 13 akuza t...

POLITIKE 14 Shtator16:03

**Braktisi PS për protestën/ Deputetja Marjana Koçeku tregon nëse ka pasur kontakte me Ramën**

Deputetja e pavarur Marjana Koçeku, e cila më herët ka qenë pjesë e kampit socialist, ka treguar detaje nga seanca e parë plenar...

POLITIKE 14 Shtator15:29

**U largua me bujë nga PS/ Befason Marjana Koçeku: Kam pasur oferta politike, por…**

Deputetja e pavarur Marjana Koçeku ka zbuluar se ka marrë oferta politike nga subjekte të ndryshme, por ka vendosur të vijojë aktivit...

POLITIKE 14 Shtator15:26

**Tabaku: Mungesa e transparencës dhe konkurrencës po dëmton rrugën e Shqipërisë drejt BE-së**

Deputetja demokrate paralajmëron se procedurat e ndjekura në tenderët publikë prekin drejtpërdrejt tre kapituj të negociatave, nd&...

POLITIKE 14 Shtator14:59

**Berisha hap dyert e PD-së për ambasadorin e ri të SHBA: Është i mirëseardhur në çdo kohë!**

Lideri i PD, Sali Berisha, ka reaguar publikisht lidhur me ardhjen e e pritur të ambasadorit të ri të Shteteve të Bashkuara të Amerik...

POLITIKE 14 Shtator13:04

**Deklaratat "bombë" të ish-zv.kryeministrit për trafik armësh, Berisha: Familja e Ahmetajt është kërcënuar pas denoncimit**

Kreu i partisë Demokratike, Sali Berisha ka komentuar deklaratat bombë të ish-zëvendëskryeministrit Arben Ahmetaj se qeveria Rama b&e...

POLITIKE 14 Shtator12:37

**"Rama u tmerrua në sarajet e Surrelit" – Berisha mban konferencën e parë pas udhëtimit në SHBA: Shkova të kërkoj ndihmën e administratës amerikane…**

Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha, ka zhvilluar një konferencë për mediat pas rikthimit nga vizita e tij në Shtetet e Bashkuar...

POLITIKE 14 Shtator12:25

**'Vit i ri shkollor me problematika të vjetra', Xhixho: Shqipëria humbi rreth 5,900 nxënës, ose rreth 4%**

Deputetja e PL, Erisa Xhixho teksa ka uruar nxënësit dhe mësuesit për vitin e ri shkollor, u shoreh se ky vit nis sërish me problemat...

POLITIKE 14 Shtator11:53

**'Corriere della Sera': Protestat shndërrohen në lëvizje kundër qeverisë, kërkohet dorëheqja e Ramës**

Protestat kundër Edi Ramës kanë vazhduar për 106 ditë me radhë. Ndërkohë protesta e të shtunës shënoi n...

POLITIKE 14 Shtator08:00

**107-të protesta, diaspora bashkohet me mijëra qytetarë në shesh: Rama jep dorëheqjen**

Protestat kundër qeverisë vijojnë edhe këtë të hënë në Tiranë, ndërsa aksioni qytetar shënon dit&e...

## ME TE VIZITUARAT

BOTA 13 Shtator

**"Kaos" në fluturimin Australi-Katar/ Dy burra p...**

Një incident është regjistruar në bordin e një fluturimi nga Melburni drejt Dohas, ku dy pasagjerë meshkuj u bënë agre...

AKTUALITET 13 Shtator

**Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...**

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

AKTUALITET 13 Shtator

**E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Grattori për Bizaniat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

[Gratteri për Piranjat: Kam 30 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik]

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

### video




### Reagon Cllevio!






**Reagon Cllevio!**



**Matilda,Piranja jonë vegjetariane: gjatë javës kap të korruptuarit, të dielën thyen rekorde në male!**




**Deklarata e Gjestit!**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.